



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:053487

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05601542

C.nr. 447/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Besnik Shala në çështjen juridike - kontestimore të paditësit: R.K, Q, M e P dhe M S, e përfaqësuar nga A.Sh e R.K, kundër të paditurit L.H, me vendbanim rr.”.....” nr...., Pejë, me bazën juridike, pasurim i pa bazë, vlera e kontestit, 190.00€, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe publike, me datën 16.04.2024 mori kurse me datën 22.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR**, kërkesë padia e paditëses R e K, Q, M e P dhe M.S, kundër të paditurit paditurit L.H, me vendbanim rr.”.....” nr.... dhe **DETYROHET** i padituri paditurit L.H, që në emër të pasurimit të pa bazë që shumën e mjeteve në vlerë prej 190.00€ ti kthej në llogarinë e paditëses R.K, Q, M e P dhe M S, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcenim të përmbartimit të dhunshëm.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.**

A r s y e t i m

Paditësja në këtë gjykatë me datën, 12.03.2021, ndaj të paditurit ka ushtruar padi, me bazën juridike, pasurimi pa bazë, vlera e kontestit, 190.00 euro.

I autorizuari i paditësve me padi, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: nga provat është dëshmuar që i padituri në të njëjtën kohë sa ka qenë bartës i të drejtës sociale ka qenë dhe i punësuar që sipas Ligjit për skemat sociale është ndaluar dhe andaj mbi këtë bazë M e M dhe P.S kërkon kthimin mjeteve të pranuar nga pala paditur në lartësi prej 190 euro dhe në rastin konkret pala paditëse heq dorë nga kamata ligjore dhe për shpenzimet procedurale dhe njëherit i propozojmë gjykatës që padinë dhe kërkesën e saj të aprovoj në tërësi si të bazuar.

Gjykata bazuar në nenin 423 par.4 të LPK-së, konstaton se seanca e datës 16.04.2024 mbahet në mungesë të këtu të paditurit L.H për ku i njëjti ishte ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e kishte arsyetuar.

Gjykata në këtë çështje juridike - kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palës paditëse ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat: të dhënat e parashtruesit të kërkesës për L.H, fletë dorëzimi i QPS-së me nr. 0/7, i dt. 18.01.2021, transferi i ATK-SNS i dt. 12.2020, deklarata e L.H, aktvendimi nr. 15258 i dt. 15.12.2020, aktvendimi me nr. 15258 i dt. 10.01.2020, formulari për përlllogaritjen e të mirave materiale 9 faqe, kërkesa për Ndihmë Sociale, vërtetimi nga Komuna e Pejës i dt. 05.02.2020 për L.H, certifikata që nuk posedon paluajtshmëri me nr. protokoli 510-2020, certifikata që nuk posedon paluajtshmëri me nr. protokoli 515-2020, vërtetimi nga shkolla e mesëm e Mjekësisë në Pejë me nr. 127/20 e dt. 10.02.2020, Shiqohet letërnjoftimi kopje për L.H, ekstrakti i lindjes për L.H, deklarata e bashkësisë familjare për L.H, certifikata e vdekjes për A.H, formulari i aplikimit me nr. 40000540284 për L.H, drafti mbi parashtrimin e kërkesës për ndihme sociale, vlerësimi i komisionit mjekësor për L.H, raporti nga konsulta për L.H i dt. 22.09.2020, raporti nga konsulta për L.H i dt. 30.01.2020.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku e në lidhmëni njëra me tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore - LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike - civile duhet vendosur si në dispozitiv, të këtij aktgjykimi, pasi që: Kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar.

Fillimisht, gjykata konstaton se përmes ekstraktit të lindjes L.H e dt. 16.05.2014 si dhe deklaratës për bashkësinë familjare e dt. 30.01.2015, vërtetoi faktin se i padituri L.H me L.H e lindur me dt.10.01.2002 dhe A.H i lindur me dt.10.10.2006 në Pejë, janë në marrëdhënie familjare përkatësisht në lidhje gjaku, ku i padituri është prindi i L.H dhe A.H.

Me aktvendimin me numër 15258 i datës 10.02.2020, gjykata vërtetoi faktin se L.H, i ishte aprovuar kërkesa për ndihmë sociale nga data 10.02.2020 e deri me datën 30.01.2021, nga M e P dhe M S me kusht që gjatë kësaj periudhe familja ti plotësojë kriteret ligjore për skemën e Ndihmës Sociale (pika II e këtij aktvendimi), kurse në pikën III të këtij aktvendimi, familja është obliguar që për çdo ndryshim të rrethanave soico-ekonomike të njoftojë Qendrën Për Punë Sociale.

Më pas, përmes Aktvendimit me numër 15258 i dt. 15.12.2020, të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, i është ndërprerë pagesa e ndihmës sociale familjes së L.H i lindur me datë 13.06.1967, me nr. personal 1009455614, me vendbanim në rr. "....." nr.56, Pejë, për shkak se anëtari i familjes është gjetur në listat e ATK –së, e i cili vendim ka hyrë në fuqi që nga dita e nënshkrimit.

Nga njoftimi i ATK për periudhën dhjetor 2020, gjykata vërtetoi faktin se vajza e të paditurit, L.H, në muajin nëntor të vitit 2020 nga firma M.H B.I, ka pranuar të hyra financiare nga ky biznes, e ku në këtë periudhë, familja e tij ka qenë shfrytëzuese e ndihmave sociale në lartësi prej 190.00 euro.

Gjykata nga të lartcekurat, ka vërtetuar këtë gjendje faktike se të paditurit i është aprovuar kërkesa për ndihmë sociale si person që ka plotësuar kushtet nga data 10.02.2020 e deri me datën 30.01.2021, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ku ishte njoftuar qysh me vendim se në rast se ndryshon gjendja financiare është e obliguar që të njoftoj QPS, e ku më pas, vajza e tij në muajin nëntor 2020 ka realizuar të hyra financiare e që u vërtetua përmes dëshmisë nga ATK, e si rezultat i kësaj paditësjë i ka ndërprerë ndihmat sociale për të paditurën. Se i padituri me personin L.H, janë në lidhje familjare, përkatësisht babë dhe bijë, u vërtetua përmes dëshmisë së bashkësisë familjare (Çertifikata).

Se paditëses i takon e drejta që i padituri të ia kthejë të hollat që ka pranuar pa bazë ligjore, e që u vërtetua si më lartë, ku kjo gjen mbështetje në dispozitën e nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr.08/2010 për procedurat administrative të kthimit të pagesave nga shfrytëzuesit e skemës së ndihmës sociale të fituara pa bazë ligjore, e lidhur me nenin 5 par. 1 të po të njëjtit udhëzim ku përcaktohet se *“Në rastet kur Njësia e Kontrollit dhe Mbikëqyrjes apo Organi i Autorizuar i Autoritetit Përkatës, gjatë procedurave të kontrollit dhe inspektimit, vlerëson se faktet e prezantuara në kërkesën për ndihmë sociale nuk janë të vërteta apo se shfrytëzuesi i ndihmës sociale nuk e ka informuar Autoritetin Përkatës për ndonjë ndryshim të rrethanave të cilat ndikojnë në shfrytëzim e paligjshëm të ndihmës sociale, shfrytëzuesi i ndihmës sociale është i obliguar t’i kthejë të gjitha ato pagesa të ndihmës sociale të cilat i ka marrë nga ndryshimi i statusit socio-ekonomik të tij.”* Obligimi i të paditurës për ndryshim të rrethanave ekonomike rrjedh dhe nga neni 8 par 2 i Ligjit nr. 2003/15 Për Skemën e Ndihmës Sociale të Kosovës ku parasheh *“Familja që merr ndihmë sociale duhet ta informojë menjëherë organin përkatës për çdo ndryshim të rrethanave, të cilat mund të ndikojnë në të drejtën e tyre për ndihmë sociale”*.

Sa i përket aplikimit të drejtës materiale, apo bazës juridike të kërkesëpadisë, sipas nenit 2.2 të LPK-së, gjykata nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale, por të njëjtën e çmon sipas çmuarjes së lirë, andaj në çështjen konkrete paditësi të drejtën e tij për të i ofruar gjykata mbrojtje juridike për realizimin e kërkesës së tij pretendonte se e ka nga burimi i drejtës së detyrimeve i Pasurimit të pa bazë ashtu siç e ka përcaktuar në padinë e tij, por që edhe gjykata me këtë rast konsideron se në këtë çështje kontestimore duhet të aplikohen dispozitat nga neni 194 i LMD-së, pra rregullat e pasurimit të pa bazë.

Përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës lidhur me zbatimin e të drejtës materiale në bazë çmuarjes së lirë dhe gjendjes faktike të diktuar nga zhvillimi i çështjes është se pala e paditëse mbrojtjen gjyqësore për të realizuar kërkesën e ka të bazuar konform burimit material nga drejta e detyrimeve *“pasurim i pa bazë”* ku në bazë të këtij burimi parashihet forma e dëmit sipas nenit 194 par. 1 të LMD-së *“Secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga tjetri, ose ndryshe të kompensojë vlerën e fitimit të arritur”*. Për lindjen e pasurimit të pa bazë, duhet të përmbushen disa kushte si: a) që të ekzistoj pasurimi i cili mund të shprehet në rritjet të aktivitetit dhe zvogëlim të pasivitetit, b) që pasurimi të jetë shkaktuar në kurriz – dëm të personit tjetër e që mund të jetë i shprehur me kalimin e një pjese të pasurisë nga një person në personin tjetër, më pagesën e shumës e të hollave, në dorëzimin e ndonjë sendi apo më kryerjen e ndonjë veprimi c) që të ekzistoj lidhja shkakore në mes të pasurimit dhe varfërimit dhe d) pasurimi duhet të jetë bërë pa bazë juridike apo në fillim

gjegjësisht në krijimin e raportit të detyrimeve baza juridike ka ekzistuar mirëpo me kalimin e kohës ajo bazë ka dështuar.

Gjykata, vlerëson se me këtë rast janë plotësuar këto kushte ligjore, për shkak se i padituri është pasuruar në shumën prej 190.00 euro kurse paditësja është varfëruar në këtë shumë, ku të paditurit i është rritur aktiva, ndërsa është shkaktuar në dëm të paditëses kjo rritje, dhe se ky pasurim i të paditurës ka ardhur pa bazë ligjore, ngase e paditura qysh kur ka fituar të drejtën për asistencë sociale ka qenë e njoftuar për obligimin e saj që të njoftoj QPS-ën për ndryshimet e rrethanave socio ekonomike, në këtë rast kur vajza e tij është punësuar dhe ka pranuar pagë, por që më pas kjo bazë juridike ka rënë për shkak se Ministria i ka ndërprerë asistencën sociale për faktin e sipër cekur, se djali i të paditurës ka pranuar pagë.

Meqenëse i padituri me asnjë provë të vetme, nuk e ka argumentuar të kundërtën, e cila as që është paraqitur në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe as që ka bërë përgjigje në padi, andaj gjykata është vënë para një situatë të tillë dhe duke u bazuar në këtë gjendje faktike erdhi në përfundim dhe vërtetoi se ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditëses për pasurim të pa bazë, në shumën prej: 190.00 euro.

Tutje Gjykata ka shton se duke ju referuar dispozitës së nenit 7 të LPK-së, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa me dispozitat e nenit 319.1 të LPK-së, parashihet se secila palë ndërgjyqëse ka për detyrë ti provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta, sepse në rastin konkret paditësi, me provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor arriti të argumenton bazën e kërkesëpadisë dhe lartësinë e saj edhe pse ligjërisht si palë paditëse ka për detyrë ta bëj atë, konkretisht të provojë faktin se e paditura është përgjegjëse që të kthejë të hollat për lartësinë që është pasuruar pa bazë ligjore.

Gjykata nuk ka dhënë vlerësim për provat e tjera të cilat i ka administruar, ngase të njëjtat kanë pas të bëjnë me procedurën administrative për realizimin e të drejtës në skemë sociale, dhe si të tilla nuk kanë qenë të rëndësishme për çështjen, ngase vendimtare ka qenë nëse i padituri e kishte asistencën sociale, nëse e njëjta i është ndërprerë dhe nëse familjari i tij ka pranuar të hyra financiare nga puna gjatë periudhës sa ka qenë me asistencë sociale, e të cilat i vërtetuan përmes provave të e laboruara si më lartë.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata vendosi në bazë të nenit 450 të LPK-së, ngase pala paditëse si organ shtetëror është ë liruar nga taksat gjyqësore, kurse shpenzime të tjera nuk janë krijuar.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 par.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:053487 - C.nr.447/21, 22.04.2024

Gjyqtari
Besnik Shala

Këshillë Juridike:

Kundër këtij Aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate. Ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave mbi procedurën kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, sipas nenit 490.1 të LPK-së.